

## Konkluzione për Republikën e Maqedonisë

*(ekstrakt nga Kumtesa e Komisionit për Parlamentin Evropian dhe për Këshillin "Strategjia për zgjerim dhe sfidat kryesore 2012-02013", KOM (2012)600 versioni i fundit)*

*Sekretariati për Çështje Evropiane intervenoi në tekst me zëvendësimin e referencës "ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë" me emrin kushtetues "Republika e Maqedonisë"*

Republika e Maqedonisë vazhdon t'i përmbushë në mënyrë të mjaftueshme **kriteret politike**. Vendi edhe më tutje vazhdon t'i plotësojë angazhimet në pajtim me Marrëveshjen për stabilizim dhe asocim. Qeveria e vendosi agjendën e BE-së në qendër të aktiviteteve të saj. Dialogu aderues i nivelit të lartë (HLAD) me Komisionin shërbeu si katalizator për përshejtimin e reformave dhe kontribuoi për progres të konsiderueshëm në një numër të madh të sferave kryesore politike. Qeveria miratoi propozime për përmirësimin e kornizës legjislative për zgjedhje edhe në sferën e lirisë së shprehjes, për dekriminalizimin e shpifjes. Shqyrtimi i parë i Marrëveshjes kornizë të Ohrit nga Qeveria është vegël për përforcimin e dialogut ndëretnik. Momenti i reformave duhet të përmbahet në të gjitha sferat e kriterëve politike, veçanërisht për realizimin e zbatimit. Kuvendi e shqyrton legjislacionin përkatës. Duhet t'i përkushtohet vëmendja sundimit të së drejtës, duke i përfshirë edhe lirinë e shprehjes, si dhe marrëdhëniet ndëretnike dhe pajtimin. Qasja inkluzive me shoqërinë civile duhet të avancohet.

Marrëveshje kornizë e Ohrit (MKO) edhe më tutje është element themelor për **demokracinë dhe sundimin e së drejtës** në vend. Qeveria filloi me shqyrtimin e zbatimit të MKO-së që nga vitit 2001, me qëllim që të krijohet konsensus për rezultatet dhe sfidat që paraprijnë. Tensionet ndëretnike pas incidenteve të dhunshme në gjysmëvjetorin e parë të vitit 2012, shkaktuan brengosje. Qeveria kësaj sfide iu përgjigj me pjekuri dhe kjo duhet të sendërtohet që në mënyrë plotësuese t'i përforcojë marrëdhëniet ndëretnike dhe pajtimin, duke e përfshirë edhe statusin e viktimave nga konflikti i vitit 2001. Është arritur progres i caktuar plotësues lidhur me zbatimin më të gjerë të Ligjit për gjuhë.

Funksionimi i *kuvendit* është përmirësuar dhe mbahet dialog politik, veçanërisht sa i përket integritimit në BE. Ekziston progres në zbatimin e Ligjit për gjuhë dhe Rregullores. Qeveria miratoi propozime për përmirësimin e kornizës për zgjedhje, të cilat tani po shqyrtohen në Kuvend. Nevojitet që të bëhen përpjekje të vazhdueshme për përmbushjen e plotë të rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it.

Vazhdoi bashkëpunimi në koalicionin qeveritar dhe i njëjti ishte i suksesshëm në tentim për ta vendosur procesin aderues në qendër të agjendës politike. Qeveria në mënyrë efikase e koordinon zbatimin e HLAD-it në bazë të

Udhërrëfyesit të vet. Në fushën e vetadministrimit lokal, duhet përshpejtuar progresi lidhur me decentralizimin, veçanërisht sa i përket kornizës financiare.

Sa i përket *administratës publike*, është arritur progres i caktuar. Shërbimet e qytetarëve u përmirësuan dhe gradualisht vendoset qeveria elektronike (e-qeveria). Vijnë konsultimet për reformat kryesore që kanë të bëjnë me kornizën e administratës. Nevojiten përpjekje plotësuese me qëllim që të garantohet transparenca, profesionaliteti dhe pavarësia e administratës publike. Veçanërisht, duhet të sigurohet respektimi i parimit të punësimit dhe avancimit në bazë të meritave.

Sa i përket *gjyqësisë*, në funksion janë masat mbrojtëse legislative dhe institucionale, por nevojiten përpjekje plotësuese që të garantohet pavarësia dhe paanshmëria në praktikë. Është arritur progres, veçanërisht në zvogëlimin e rasteve të mbetura. Nevojiten përpjekje plotësuese që të krijohen baza të qarta dhe transparente për procedura proporcionale për zgjidhje dhe në mënyrë të konsiderueshme të përmirësohet realizimi i emërimit të gjykatësve në bazë të meritave dhe zhvillimi i karrierës. Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë duhet që në mënyrë plotësuese të mbështetet në rolin e saj kryesor në zhvillimin e shërbimit profesional dhe me kualifikim të lartë të gjyqësisë dhe prokurorisë.

Në sferën e *politikës së antikorrupsionit*, ekziston kornizë ligjore dhe kapacitetet janë përforcuar sadopak, por nevojiten përpjekje më të mëdha lidhur me zbatimin ligjeve ekzistuese. Janë marrë hapa për përmirësimin e kapaciteteve për verifikim, dhe të autorizimeve ekzekutive të organeve. Megjithatë, është arritur progres i dukshëm i vogël lidhur me rezultat përfundimtarë. Fillimisht duhet të mbahet evidencë për menaxhim me rastet e korrupsionit në nivel të lartë. Nevojitet shkallë më e lartë e proaktivitetit dhe koordinimit, nga ana e trupave për supervizion dhe organeve për zbatimin e ligjit. Duhet të përmirësohet mbledhja dhe analiza e të dhënave statistikore, për orientimin e përpjekjeve ku ka nevojë më së shumti. Korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha dhe vazhdon të jetë problem serioz.

Është arritur progres i caktuar lidhur me *luftën kundër krimit të organizuar*, veçanërisht përmes lëshimit të mbi 100 urdhërësive ndërkombëtare për arrestim dhe bashkëpunimit të mirë nëpërmjet Interpolit dhe me Europolin. Ligji për ndjekjen e komunikimeve u ndryshua, me çfarë u përforcua efikasiteti dhe transparenca e masës së veçantë hetimore. Nevojiten përpjekje të mëtutjeshme për përforcimin e kapaciteteve të organeve ekzekutive dhe për përmirësimin e bashkëpunimit të tyre të ndërsjellë dhe shkëmbimin e informatave. Vendi ka përparim në sferën e bashkëpunimit policor dhe luftës kundër krimit të organizuar.

Korniza juridike dhe institucionale për **të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e minoriteteve** është vendosur plotësisht. *Të drejtat civile dhe politike* respektohen në pjesën më të madhe, ndërsa është bërë edhe progres i caktuar plotësues. Dialogu me gazetarët në tryezën e rrumbullakët u tregua si forum i rëndësishëm për zgjidhjen e sfidave kryesore në sferën e medie. Qeveria miratoi propozime për dekriminalizimin e shpifjes nëpërmjet miratimit

të Ligjit për përgjegjësi civile për ofendim dhe shpifje. Kodi penal duhet të revidohet në pajtim me këtë qasje. Këshilli i Radiodifuzionit filloi me zbatimin e dispozitave ligjore kundër koncentrimin të pronësisë dhe konfliktit të interesave me sferën politike. Këshilli i Radiodifuzionit duhet të tregojë se ndjek qasje jodiskriminuese dhe transparente. Mbetet e madhe brengosja lidhur me mungesën e pluralizmit dhe vetëcensurës. Nevojiten përpjekje të vazhdueshme për t'u përgjigjur sfidave të lidhura me këtë siç janë transparenca e reklamimit të qeverisë dhe të drejtat e punës të gazetarëve.

Mund të vërehet progres i caktuar lidhur me përfundimin e *të drejtave sociale dhe ekonomike*. Këshilli Ekonomik-Social mban takime rregullisht. Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi është angazhuar në përpunimin e ankesave edhe pse resurset e tij janë të kufizuara. Ligji për anti-diskriminim duhet të harmonizohet plotësisht me *acquis*, veçanërisht lidhur me diskriminimin në bazë të orientimit seksual. Ekziston nevojë për mbrojtje më të mirë të të drejtave të grave, duke i përfshirë nga grupet e cënueshme, si dhe përpjekje plotësues për zmadhimin e pjesëmarrjes së tyre në tregun e punës dhe në jetën politike. Integrimi social i personave me invaliditet edhe më tutje mbetet i dobët.

Marrë në përgjithësi, u arrit progres i caktuar në sferën e *të drejtave kulturore dhe pakicave*. Filloi shqyrtimi i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit që përfshin rekomandime për zgjidhjen e sfidave vijuese. Duhet të ndiqet shqyrtimi dhe bashkëpunimi konkret etnik. Me rëndësi kryesore do të jetë përfundimi i mirëbesimit ndërmjet komuniteteve etnike. Lidhur me romët, u morën disa aktivitete, veçanërisht për zgjidhjen e çështjeve të personave pa dokumente dhe për integrimin e romëve refugjatë. Duhet në mënyrë të konsiderueshme të përfundohet zbatimi i strategjive ekzistuese dhe bashkëpunimi ndër-institucional.

Në aspekt të ***çështjeve rajonale dhe obligimeve ndërkombëtare***, vendi vazhdon plotësisht të bashkëpunojë me Gjykatën Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë (GJNJ). Nuk ka raste ose ankesa të mbetura në procedurë në HAG. Nga katër lëndët që GJNJ-ja ua ktheu prapa autoriteteve nacionale në vitin 2008, njëra u zgjodh në vitin 2011 nga sistemi gjyqësor i vendit, ndërsa tri lëndët tjera u zgjidhën në vitin 2012, në pajtim me kërkesën e Prokurorisë Publike dhe në bazë të Ligjit për amnisti.

Sa i përket Gjykatës Penale Ndërkombëtare, marrëveshja bilaterale për imunitet me Shtetet e Bashkuara nuk është në pajtim me Qëndrimin e përbashkët dhe parimet kryesore të BE-së. Vendi duhet të harmonizohet më qëndrimin e BE-së.

Vendi edhe më tutje merr pjesë aktive në iniciativat rajonale për bashkëpunim, duke e përfshirë edhe procesin për bashkëpunim në Evropën juglindore (SEECP), Këshillin për bashkëpunim rajonal (KBR) dhe Marrëveshjen qendrore-evropiane për tregti të lirë (CEFTA). Ajo e mori kryesimin në Zyrën e SEECP-së në qershor të vitit 2012. Selia e Sekretariatit të rrjetit shëndetësor të Evropës Juglindore (SEEHN) është themeluar në Shkup. Vendi edhe më tutje vazhdon të kontribuojë në misionin e BE ALLTEA në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Republika e Maqedonisë mban rol plotësisht konstruktiv lidhur me

marrëdhëniet bilaterale me vendet fqinje-anëtare dhe vendet tjera që janë pjesë e procesit për zgjerim. Marrëdhëniet me partnerët në Ballkanin Perëndimor zhvillohen në mënyrë plotësuese. Marrëdhëniet me Greqinë mbeten nën ndikimin e çështjes për emrin. Gjykata ndërkombëtare e drejtësisë miratoi aktgjykim lidhur me Marrëveshjen e përkohshme me Greqinë. Vendi vazhdoi me negociatat, nën patronazhin e KB-së dhe nëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta me Greqinë. Bisedimet nën patronazhin e KB-së për negociata dhe zgjidhje të pranueshme të dyanshme duhet arrihen me dëshirë të madhe, nëpërmjet realizimit të takimeve dhe kontakteve bilaterale. Duhet të shmangen aktivitetet dhe deklaratat që ndikojnë negativisht në marrëdhëniet e mira fqinjësore.

**Ekonomia** e vendit vazhdoi të rritet me tempo të ngadalësuar në vitin 2011, por u zvogëlua në gjysmëvjetorin e parë të vitit 2012. Rritja bazohet në kërkesën e qëndrueshme vendore, ndërsa kërkesa e jashtme është në rënie. Vazhduan reformat strukturore, por tërësisht me tempo graduale dhe të ngadalshme. Ekziston progres i caktuar i mëtutjeshëm në thjeshtësimin e regjistrimit të firmave, përshpejtimin e procedurave gjyqësore dhe thëllimin e ndërmjetësimit financiar. Megjithatë, ekziston arritje e vogël në zgjidhjen e shkallës shumë të lartë të papunësisë, e cila më shpesh është strukturore dhe ndikon kryesisht te të rinjtë dhe të paarsimuarit.

Në aspekt të **kritereve ekonomike**, Republika e Maqedonisë vazhdon me progresin e mirë. Në sfera të caktuara, ka bërë progres të mëtejme në ekonominë funksionale të tregut. Vendi duhet të jetë i aftë të ballafaqohet me presionet konkurruese dhe forcat e tregut në kuadër të BE-së në afat të mesëm, me kusht që të zbatohet programi reformues me qëllim të zvogëlimit të dobësive të konsiderueshme strukturore.

Vendi mbajti konsensus të gjerë për çështje esenciale të politikave ekonomike. Politika monetare, e bazuar de fakto në kursin fiks devizor për euron, kontribuoi për stabilitetin makroekonomik. Politika fiskale e ruajti shpenzimin kryesisht në pajtim me rritjen e të hyrave. Privatizimi në pjesën më të madhe ka përfunduar. Liberalizimi i çmimeve dhe tregtisë në masë të madhe ka përfunduar. Është arritur progres plotësues në lehtësimin e hyrjes në treg dhe në thjeshtësimin e kornizës rregullatore. Kohëzgjatja mesatare e procedurave të përshpejtuara gjyqësore të procedurave të falimentimit është zvogëluar. Regjistrimi i pronës pothuajse gati ka përfunduar. Sektori financiar deri më tani i tejkaloi mirë turbulencat e tregut financiar dhe e mbajti trendin e zmadhimit të ndërmjetësimit dhe zgjerimit të tregut. Vazhdon progresi gradual në sektorin e arsimit.

Zmadhimi i investimeve të huaja të drejtpërdrejta ndihmuan që të zgjerohet struktura eksportuese e tregut.

Megjithatë, cilësia e sundimit fiskal në mënyrë plotësuese u përkeqësua; u përkeqësua planifikimi afatmesëm dhe menaxhimi me shpenzimet publike, ndërsa u zvogëlua niveli i transparencës dhe sigurisë së llogarive të sektorit publik. Më tutje, orientimi afatshkurtër për shpenzimin me rritje të ulët me zmadhimin e efikasitetit vazhdoi, Borxhi i sektori publik u zmadhua në masë të konsiderueshme. Papunësia mbetet shumë e lartë. Funksionimi i tregut të punës pengohet nga dobësitë strukturore. Niveli i arsimit dhe kualifikimit të

kapitalit njerëzor është i ulët. Ngjashëm me këtë, kapitali fizik duhet të modernizohet dhe thellohet.

Krahas përmirësimit gradual në funksionimin e ekonomisë së tregut edhe më tutje vazhdon të pengohet nga dobësitë institucionale dhe gjyqësore.

Disa agjenci rregullatore dhe mbikëqyrëse ende nuk i kanë resurset dhe forcën të nevojshme për t'i plotësuar në mënyrë efikase funksionet e veta. Kapaciteti dhe efikasiteti i administratës publike në sigurimin e shërbimeve për ndërmarrje kërkon përmirësim. Sektori joformal mbetet sfidë e rëndësishme.

Republika e Maqedonisë shënoi progres në përmirësimin e **aftësisë së saj për marrjen e obligimeve për anëtarësim**, veçanërisht në sferat e qarkullimit të lirë të mallrave, konkurrencës, sigurisë së ushqimit dhe politikës veterinarë dhe Rrjeteve Trans-Evropiane. Nevojiten përpjekje plotësuese në sfera tjera siç janë mjedisi jetësor, politika sociale dhe punësimi dhe politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore. Marrë në përgjithësi, vendi ka arritur nivel të mirë të harmonizimit me *acquis* në këtë fazë të procesit aderues. Gjithashtu vazhdon në mënyrë të papenguar t'i realizojë obligimet në pajtim me Marrëveshjen për stabilizim dhe asocim (MSA) dhe Komisioni propozoi që të kalojë në fazën e dytë të asocimit.

Progres i mirë është arritur në sferën e *qarkullimit të lirë të mallrave*, veçanërisht në sferën e standardizimit dhe metrologjisë. Përgatitjet në sferën e qarkullimit të lirë të mallrave shënojnë progres. Është bërë progres i caktuar në sferën e *lëvizjes së lirë të punëtorëve*. Progres i caktuar mund të vërehet në sferën e *të drejtës së themelimit dhe lirisë së dhënies së shërbimeve*, veçanërisht lidhur me shërbimet postare. Megjithatë, përpjekje të mëtutjeshme nevojiten lidhur me zbatimin e direktivës për shërbime dhe njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve profesionale. Marrë në përgjithësi, shteti shënon progres në këtë sferë. Ka progres të caktuar në sferën e *qarkullimit të lirë të kapitalit*. Liberalizimi i mëtutjeshëm i qarkullimit të kapitalit dhe pagesave është lëndë e tranzicionit në fazën e dytë të MSA-së, që shqyrtohet nga Këshilli. Përgatitjet në këtë sferë janë në drejtim të mirë.

Progres i caktuar është arritur në sferën e *furnizimeve publike*, ku niveli i harmonizimit ka përparuar, me përjashtim të mjeteve juridike dhe furnizimeve në sferën e mbrojtjes. Kapaciteti administrativ në sferën e mjeteve juridike dhe koncesioneve edhe më tutje mbetet i dobët. Progres i mirë është bërë edhe në sferën e *legjislacionit të shoqërive tregtare*, veçanërisht në sferën e revizionit. Kualifikimet e revizorëve të autorizuar të marra në vend të huaj duhet fillimisht të pranohen. Marrë në përgjithësi, në këtë sferë përgatitjet shënojnë progres mesatar. Progres i caktuar është arritur në sferën e *pronësisë intelektuale*, ku korniza legjislative dhe kapaciteti administrativ u përmirësuan në mënyrë plotësuese. Megjithatë, përpjekje më të mëdha nevojiten në sferën e zbatimit dhe aplikimit. Marrë në përgjithësi, harmonizimet në këtë sferë shënojnë progres mesatar.

Progres i mirë është arritur në sferën e *politikës së konkurrencës* me përmirësimin e evidencës për përmbarrim. Në këtë sferë përgatitjet shënojnë progres. Nevojitet që në mënyrë plotësuese të përforcohet ndihma resurseve

të organit kompetent për konkurrencë. Lidhur me *shërbimet financiare*, është arritur progres në sferën e sistemit bankar, sigurimit dhe tregjeve të letrave me vlerë dhe shërbimeve investuese. Mbetet që të kryhet harmonizim me *acquis* në sferën e infrastrukturës së tregut financiar. Marrë në përgjithësi, harmonizimi me *acquis* në këtë sferë shënon progres mesatar.

Mund të vërehet progres në sferën e *shoqërisë informatike dhe medie*. Harmonizimi me *acquis* vazhdoi dhe masat kryesore mbrojtëse konkurruese filluan të zbatohen. Në sferën e politikës audiovizuale, aktivitetet e Këshillit të Radiodifuzionit u shtuan, por duhet të sigurohet qasje jodiskriminuese. Në këtë sferë përgatitjet shënojnë progres mesatar. Progres i caktuar është arritur në sferën e *zhvillimit bujqësor dhe rural*, ku përgatitjet mbeten mesatarisht të avancuara. Ekziston përmirësim i mëtutjeshëm në përcaktimin e sistemit të integruar për administrim dhe kontroll. Harmonizimi me *acquis* kërkon përpjekje të mëtutjeshme. Kapaciteti administrativ mbetet brengë për tërë sektorin.

Ekziston progres i mirë në sferën e *sigurisë së ushqimit dhe politikës veterinarë*, veçanërisht lidhur me përforcimin e institucioneve dhe zbatimin e programeve për çrrënjosjen e sëmundjeve të kafshëve. Progres i vogël vërehet në *sferën fitosanitare*, ku kapaciteti administrativ dhe koordinimi ndërmjet organeve kompetente nuk është përmirësuar. Përgatitjet marrë në përgjithësi në sferën e sigurisë së ushqimit, politikës veterinarë dhe fitosanitare mbeten mesatarisht të avancuara.

Mund të vërehet progres i vogël edhe në sferën e *politikës së transportit*. Progres i caktuar mund të vërehet në harmonizimin me *acquis* në transportin rrugor, por jo në sigurinë e rrugëve, gjë mbetet brengë. Legjislacioni për komunikacionin hekurudhor duhet mëtej të harmonizohet me *acquis*. Ndryshimi i legjislacionit për mbylljen e tregut në komunikacionin hekurudhor për konkurrencë deri në aderim në BE e zbraps harmonizimin tanimë të arritur me *acquis*. Komiteti për hetim të fatkeqësive në hekurudhë duhet bëhet operativ me qëllim që të veprojë si trup i pavarur. Progres i caktuar është arritur në *sektorin energjetik*, veçanërisht me miratimin e legjislacionit për zbatim që rrjedh nga Ligji për energjetikë i vitit 2011. Gjithashtu, është arritur progres i caktuar në sektorin e energjisë rigjeneruese. Tanimë duhet të arrihet liberalizim i plotë i energjisë elektrike dhe tregut të gazit natyror. Në këtë sferë përgatitjet shënojnë progres mesatar.

Vërehet progres i kufizuar në sferën e *tatimitit*. Ende nevojiten përpjekje për harmonizimin e legjislacionit nacional me *acquis-in*, që të përforcohet parandalimi i mashtrimeve tatimore dhe fshehjet tatimore dhe të merren parasysh kapacitetet e IT-së dhe kapacitetet kadrovike. Përgjithësisht, përgatitjet në sferën e tatimit mesatarisht janë të avancuara.

Përgatitjet në sferën e *politikës ekonomike dhe monetare* janë avancuar dhe është arritur progres i vogël plotësues. Përgatitjes në këtë sferë janë avancuar. Në sferën e *statistikës*, është arritur progres në aspekt të harmonizimit të statistikës sektoriale dhe bartjes së të dhënave. Marrë në përgjithësi, përgatitjet në sferën e statistikës janë mesatarisht të avancuara.

Vërehet progres i vogël në sferën e *politikës sociale dhe punësimit*. Shkallët e papunësisë dhe varfërisë janë të larta, ndërsa pjesëmarrja e femrave në tregun e punës edhe më tutje është e dobët. Është arritur progres i caktuar në sferën e dialogut social, por roli i partnerëve socialë duhet të përforcohet më tepër. Është ratifikuar Konventa e KB-së për të drejtat e personave me invaliditet dhe Protokoll opsioni i konventës. Përfshirja e romëve, personave me invaliditet dhe personave tjerë të marginalizuar social përparon ngadalë. Mekanizmi për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi është në funksion, por nuk është plotësisht operativ. Kapaciteti i përgjithshëm administrativ duhet të përforcohet në masë të konsiderueshme. Marrë në përgjithësi, përgatitjet në këtë sferë nuk janë shumë të avancuara.

Vërehet progres i caktuar në sferën e *ndërmarrjeve dhe politikës industriale*. U miratuan strategji dhe masa të ndryshme, që tregojnë ekzistimin e përpjekjeve të fuqishme që të përmirësohet klima afariste. Megjithatë, zbatimi është përhapur në mënyrë të pabarabartë te një numër i caktuar i trupave të pakoordinuar dhe të financuar dobët. Masat tanimë duhet të bëhen plotësisht efikase.

Është arritur progres në sferën e *rrjeteve transevropiane*. Zhvillimi i rrjeteve të transportit, energjetikës dhe telekomunikimit vazhdon dhe vendi merr pjesë aktive në Opservatorin transportues të Evropës Juglindore dhe në Komunitetin Energjetik. U lidh marrëveshje dhe filluan punët rreth ndërtimit të korridorit X, të cilat janë financuar pjesërisht sipas komponentit të III-të të IPA-s. Përgatitjet në këtë sferë janë mesatarisht të avancuara.

Vërehet progres i kufizuar në sferën e *politikës rajonale dhe koordinimit të instrumenteve strukturore*. Duhet të përmirësohet menaxhimi me programet IPA që të sigurohet absorbimi i plotë dhe në kohë i fondeve të BE-së. Nevojiten përpjekje plotësuese që të zgjidhet problemi rreth mungesave në sistemet e menaxhimit dhe kontrollit. Veçanërisht duhet të përforcohen kuadri dhe kualifikimet e strukturave operative dhe Sektori për financimin dhe lidhjen e marrëveshjeve në kuadër të Ministrisë së Financave. Përgatitjet në këtë sferë janë mesatarisht të avancuara.

Vërehet progres i caktuar në sferën e *gjyqësisë dhe të drejtave fundamentale*, veçanërisht në zvogëlimin e rasteve të mbetura gjyqësore. Nevojiten përmirësime plotësuese në punësime gjyqësore në bazë të meritave, baza precize dhe të parapara për zgjidhjen e përdorimit të drejtë të mjeteve statistikore. Në sferën e politikës së antikorruptionit, korniza ligjore është në fuqi dhe kapaciteti është përforcuar pak, por nevojiten përpjekje më të mëdha që të zhvillohet evidentimi i hetimeve, padive dhe aktgjykimeve, meqë nuk është shënuar progres në këtë aspekt. Sa u përket të drejtave themelore, është arritur progres i caktuar në sferën e lirisë së të shprehurit, veçanërisht në dekriminalizimin e shpifjes. Institucionet relevante duhet të bëhen efikase në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave në praktikë. Marrëveshja kornizë e Ohrit mbetet element i rëndësishëm për demokracinë dhe sundimin e së drejtës në vend. Përgatitjet në sferën e gjyqësisë dhe të drejtave themelore janë mesatarisht të avancuara.

Është shënuar progres në sferën e *drejtësisë, lirisë dhe sigurisë*, veçanërisht

për kufijtë e jashtme dhe bashkëpunimin doganor, si dhe për ndjekjen e komunikimeve, Nevojiten përpjekje plotësuese që të përmirësohet efikasiteti i procedurës për azil, të sigurohet punësim në polici ekskluzivisht sipas meritave, të përforcohet lufta kundër krimit të organizuar të përmirësohet konfiskimi i drogës. Marrë në përgjithësi, përgatitjet në këtë sferë janë të avancuara.

Mund të vërehet progres i vogël në sferën e *shkencës dhe hetimit*. Niveli i përgjithshëm i pjesëmarrjes në programet kornizë të BE-së edhe më tutje është i mirë. Përgatitjet për Programin nacional për hulumtim dhe zhvillim të Strategjisë për inovacione janë avancuar, por dokumentet duhet të miratohen. Në këtë sferë, vendi i plotëson qëllimet pjesërisht.

Është arritur progres i caktuar në sferën e *arsimit*, trajnimit, të rinjve dhe *kulturës*. Vendi vazhdoi së përmirësuar realizimet e veta lidhur me qëllimet e përbashkëta për Arsimin dhe trajnimin 2020. Përsëri filluan masat përgatitore për programet Mësim gjatë gjithë jetës dhe Të rinjtë në aksion. Investimet duhet të aplikohen në mënyrë të barabartë për të gjitha pjesët e vendit dhe shoqërisë multikulturore, Në sferën e arsimit dhe kulturës, vendi ka përparuar mesatarisht.

Është arritur progres i kufizuar në kapitullin *mjedisi jetësor dhe ndryshimet klimatike*. Është arritur progres plotësues në transponimin e *acquis-it* në legjislacionin nacional, veçanërisht në sektorët për menaxhim me hedhurina, cilësinë e ajrit dhe kimikale. Nevojiten përpjekje të rëndësishme me qëllim të zbatimit të legjislacionit nacional, veçanërisht në sferën e menaxhimit me ujëra, kontrollit të ndotjes industriale, mbrojtjes së natyrës dhe ndryshimeve klimatike. Marrë në përgjithësi, përgatitjet në sferën e mjedisit jetësor janë avancuar mesatarisht, ndërsa në sferën e ndryshimeve klimatike mbeten në fazë të hershme.

Është arritur progres i caktuar në sferën e *konsumatorëve dhe mbrojtjes shëndetësore*, veçanërisht në aspekt të kornizës juridike dhe institucionale. Progresi i mëtutjeshëm pengohet nga resurset e kufizuara financiare dhe strukturat e dobëta operative, veçanërisht në sferën e mbrojtjes së konsumatorëve. Marrë në përgjithësi, përgatitjet në këtë sferë janë mesatarisht të avancuar.

Është arritur progres në sferën e *unionit doganor*, veçanërisht në kapacitetin administrativ dhe operativ. Vazhdon të përmirësohet bashkëpunimi ndërmjet agjencive, lufta kundër korrupsionit në administratën doganore dhe kapaciteti për parandalimin e krimit tejkufitar. Përgatitjet në sferën e unionit doganor janë në rrugë të mirë.

Është arritur progres i caktuar në sferën e *marrëdhënieve të jashtme*, veçanërisht në lidhje me politikën e përbashkët tregtare. Megjithatë, kapaciteti institucional i vendit ende nuk është i mjaftueshëm që të marrë pjesë plotësisht në politikën tregtare, zhvillimore dhe humanitare të BE-së. Përgatitjet në sferën e marrëdhënieve të jashtme janë mesatarisht të avancuara.



Është arritur progres i vazhdueshëm në sferën e *politikës së jashtme, sigurisë dhe mbrojtjes*. Vendi e mbajti nivelin e vet të lartë të respektimit të Deklaratave të BE-së dhe Vendimeve të Këshillit dhe vazhdoi të marrë pjesë në operacionet civile dhe ushtarake për menaxhim me kriza. Marrë në përgjithësi, përgatitjet në sferën e politikës së jashtme, sigurisë dhe mbrojtjes janë të avancuara mirë.

Lidhur me *kontrollin financiar*, kishte progres të caktuar, veçanërisht lidhur me revizionin e jashtëm dhe mbrojtjen e euros nga falsifikimi. Megjithatë, vendi ende është në fazë të hershme të zbatimit praktik të kontrollit të brendshëm financiar publik. Marrë në përgjithësi, përgatitjet në këtë kapitull janë në fazë të hershme. Nuk është arritur progres i veçantë lidhur me *dispozitat financiare dhe buxhetore*. Duhet të përforcohen institucionet funksionale për plotësimin e kornizës administrative për llogaritje, parashikim, grumbullim, pagesë, përcjellje dhe njoftim të rregullt të kornizës së vet të resurseve. Përgatitjet në këtë sferë janë në fazë të hershme.